




# KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

NJË  
INSTRUMENT  
I GJALLË



EUROPEAN COURT OF HUMAN RIGHTS  
COUR EUROPÉENNE DES DROITS DE L'HOMME

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

# **Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut**

Një instrument i gjallë

*Soa. Anaid*

## Përmbajtja

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut	5
Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut	5
Jurisprudenca	6
Impakti i Konventës	6
Konventa, një instrument modern	7
Reformat e sistemit të Konventës	8
Shtojca 1: Konventa shkurtimisht	10
Shtojca 2: Shtetet nënshkruese të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore	15
Shtojca 3: Data kyçe	16
Shtojca 4: Protokollet e Konventës	18
Shtojca 5: Grafiku i nënshkrimeve dhe ratifikimeve të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Traktati Nr. 005)	22

Edicioni anglisht:

The European Convention on Human Rights – A living instrument

Ky dokument, version i thjeshtuar i Konventës, është përgatitur nga Drejtoria e Komunikimit dhe ka vetëm vlerë pedagogjike ; ai ndjek versionin e thjeshtuar të Deklaratës Universale për të drejtat e njeriut botuar nga Amnesty International. Versioni zyrtar i Konventës për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore dhe Protokollet e saj, janë të vetmet tekste që kanë vlerë juridike.

Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të përkthehet, riprodhohet ose transmetohet, në çfarëdo forme ose me çfarëdo mjeti, elektronik (CD-ROM, Internet, etj.) ose mekanik, përfshirë fotokopjimi, regjistrimi ose ndonjë sistem i ruajtjes ose rikuperimit të informacionit, pa leje paraprake me shkrim nga Njësia e Marrëdhënieve me Publikun - Regjistri i GJEDNJ-së.

© Forografia: Këshilli i Evropës

© Ilustrimi: Shutterstock

© Projektimi grafik: GJEDNJ - Njësia e Marrëdhënieve me Publikun

© Faqësja: GJEDNJ - Njësia e Marrëdhënieve me Publikun


© Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, shtator 2020

Rëndësia e Konventës Evropiane qëndron në fushën e të drejtave dhe lirive që ajo mbron, por edhe në sistemin që ajo ka ndërtuar duke krijuar Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me detyrën për të mbikëqyrur përmbushjen nga ana e Shteteve të angazhimeve të tyre; një sistem në të cilin individët mund të sjellin çështjen e tyre kundër Shtetit kur të drejtat dhe liritë e tyre janë shkelur.

## Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nënshkruar në Romë më 4 nëntor 1950, ishte instrumenti i parë që kristalizoi dhe dha efekt detyrues për të drejtat e përcaktuara në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut. Ajo përcakton të drejta absolute të cilat kurrë nuk mund të shkelen nga Shtetet, siç është e drejta për jetë ose ndalimi i torturës, dhe mbron të drejta dhe liri të caktuara të cilat mund të kufizohen vetëm me ligj kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, për shembull e drejta për liri dhe siguri ose e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare.

Me miratimin e protokolleve shtesë, një numër të drejtash i janë shtuar tekstit fillestar që kanë të bëjnë veçanërisht me heqjen e dënimit me vdekje, mbrojtjen e pronës, të drejtën për zgjedhje të lira ose lëvizjen e lirë.



## Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, organi gjyqësor i Këshillit të Evropës, shqyrton kërkesa nga individë, por edhe kërkesa ndërshtetërore, të paraqitura nga një shtet kundër një shteti tjetër Palë në Konventë. Aktualisht janë 47 vende që kanë marrë përsipër të sigurojnë të drejtat dhe liritë themelore, jo vetëm për shtetasit e tyre, por për të gjithë, madje edhe joevropianë, brenda juridiksionit të tyre.

## Jurisprudenca

Praktika gjyqësore e Gjykatës është e pasur dhe ka të bëjë me çështje nga më të ndryshmet. Shkelja e Konventës më shpesh e ndeshur nga Gjykata ka të bëjë me të drejtën për një proces të rregullt ligjor, për shkak të mungesës së drejtësisë ose procedurave tepër të gjata. E drejta për liri dhe siguri dhe e drejta për mbrojtjen e pronës japin gjithashtu shkas për konstatim shkeljesh.

Gjykata ka vendosur për shumë çështje shoqërore si aborti, vetëvrasja e asistuar, kërkimet në trup, skllavëria në familje, birësimi nga homoseksualët, mbajtja e simboleve fetare në shkolla, mbrojtja e burimeve të gazetareve ose ruajtja e të dhënave të ADN-së.

## Impakti i Konventës

Arsyeja e ndikimit të rëndësishëm të punës së Gjykatës qëndron në forcën detyruese të gjykimeve të saj. Një shteti, i cili gjendet se ka kryer një shkelje, do t'i kërkohet të sigurojë dëmshpërbim për dëmin e shkaktuar ndaj kërkuesit dhe, për aq sa është e mundur, të rregullojë çdo pasojë të shkeljes. Shteti duhet gjithashtu të sigurohet që të mos ketë shkelje të ngjashme, me fjalë të tjera që askush tjetër të mos jetë viktimë e shkeljes së gjetur. Në praktikë, kjo çon shpesh në ndryshime në legjislacion.



Duke ndryshuar legjislacionin ose praktikën e tyre për t'i sjellë ato në përputhje me Konventën, Shtetet u mundësojnë të gjithëve që të përfitojnë nga zhvillimi i mëtejshëm i mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Një gjykim i vetëm mund të ketë një ndikim në të gjithë popullatën e një vendi. Mbikqyrja e ekzekutimit të një gjykimi qëndron në duart e Komitetit të Ministrave, organi ekzekutiv i Këshillit të Evropës.

Shembuj të ndryshimeve të rrjedhur nga vendimet e Gjykatës:

- **Qipro** shfuqizoi veprën penale të marrëdhënieve homoseksuale midis të rriturve me pëlqimin e tyre;
- anëtarësimi në një union nuk është më një detyrim në **Danimarkë**;
- **Franca** njehe një barazi të të drejtave të trashëgimisë midis fëmijëve të ligjshëm dhe fëmijëve të lindur jashtë martese;
- **Mbretëria e Bashkuar** ndaloi ndëshkimin trupor në shkollat shtetërore;
- **Zvicra** miratoi një ligj për të rregulluar përgjimin e telefonit
- dhe shumë shtete kanë prezantuar mjete juridike për t'u mundësuar njerëzve të ankohen për procedura të gjata të paarsyeshme.

## Konventa, një instrument modern

Ajo që i jep forcë Konventës dhe e bën atë jashtëzakonisht moderne është mënyra se si Gjykata e interpreton atë: në mënyrë dinamike, në dritën e kushteve të sotme. Me praktikën e saj gjyqësore, Gjykata ka zgjeruar të drejtat e përcaktuara në Konventë, të tilla që dispozitat e saj zbatohen sot për situata që ishin krejtësisht të paparashikueshme dhe të paimagjueshme në kohën kur u miratua për herë të parë, duke përfshirë çështje që lidhen me teknologjitë e reja, bioetikën ose mjedisin. Konventa zbatohet gjithashtu për çështje shoqërore ose të ndjeshme që lidhen, për shembull, me terrorizmin ose migracionin.

## Reformat e sistemit të Konventës

Që prej krijimit të saj në 1959, Gjykata ka përfunduar shqyrtimin e rreth 910,000 aplikimeve, qoftë duke dhënë një gjykim ose një vendim, ose duke hequr çështjen nga lista e saj.

Të ballafaquar me një numër në rritje të çështjeve, Shtetet Anëtare të Këshillit të Evropës kanë miratuar Protokolle të ndryshme të Konventës me qëllim përmirësimin dhe forcimin e mekanizmit mbikqyrës të krijuar fillimisht. Kështu, formacione të reja gjyqësore janë shtuar për të trajtuar çështjet më të drejtpërdrejta.

Paralelisht, Gjykata ka reformuar gjithashtu metodat e saj të punës në mënyrë që të rrisë efikasitetin dhe të modernizojë burimet e saj. Për shembull, ajo ka vendosur procedurën e gjykimit pilot për t'u marrë me fluksin masiv të kërkesave në lidhje me çështje të ngjashme, të njohura gjithashtu si çështje sistematike, që rezultojnë nga mos pajtimi i ligjit të brendshëm me Konventën.

Gjykata ka miratuar gjithashtu një politikë prioritizimi që merr parasysh rëndësinë dhe urgjencën e pyetjeve të ngritura në mënyrë që të vendosë për rendin në të cilin përpunohen aplikimet.



## Shtojca 1: Konventa shkurtimisht



Neni 1

**Detyrimi për të respektuar të drejtat e njeriut**

*Shtetet duhet të sigurojnë që çdokush brenda territorit apo në territorin nën juridiksionin e tyre i gëzon të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Konventë.*



Neni 2

**E drejta për jetën**

*E drejta e gjithsecilit për jetë mbrohet me ligj.*



Neni 3

**Ndalimi i torturës**

*Askush nuk mund të torturohet ose të trajtohet në mënyrë çnjerëzore ose poshtëruese.*



Neni 4

**Ndalimi i skllavërisë dhe i punës së detyruar**

*Askush nuk mund të trajtohet si skllav apo të shtrëngohet me punë të detyruar.*



Neni 5

**E drejta për liri dhe siguri**

*Çdokush ka të drejtën e lirisë. Të gjithë personat e arrestuar kanë të drejtë për t'iu treguar pse janë arrestuar, menjëherë pas arrestimit të tyre. Ata duhet të dërgohen përpara një gjyqtari menjëherë dhe të gjykojnë brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohen deri në fillimin e procesit gjyqësor kundër të tyre.*



Neni 6

**E drejta për një proces të rregullt**

*Çdokush ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e paratur dhe e paanshme.*

*Të gjithë personat që janë akuzuar për një shkelje janë të pafajshëm derisa të dëshmohet fajësia e tyre. Çdo person duhet të informohet brenda një afati sa më të shkurtër për akuzat e ngritura kundër tyre, për të përgatitur mbrojtjen. Çdo person ka të drejtë të përfaqësohet nga një avokat i paguar nga shteti nëse nuk mund ta paguajë vetë.*



Neni 7

**Nuk ka dënim pa ligj**

*Askush nuk mund të shpallet fajtor për një shkelje që nuk ka ekzistuar si e tillë në kohën kur ka ndodhur ngjarja.*



Neni 8

**E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare**

*Të gjithë personat kanë të drejtën e respektimit të jetës së tyre private dhe familjare, të shtëpisë së tyre dhe të korrespondencës së tyre.*



Neni 9

**Liria e mendimit, e ndërgjegjës dhe e fesë**

*Të gjithë personat kanë të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjës dhe të fesë. Secili mund të praktikojë besimin fetar publikisht ose privatisht dhe të ndryshojë fenë.*



Neni 10

**Liria e shprehjes**

*Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të dhënë apo për të pranuar informacione dhe ide.*



### Neni 11

#### Liria e tubimit dhe organizimit

Çdokush ka të drejtë të marrë pjesë në tubime paqësore dhe t'u bashkohet shoqatave. Kjo përfshin të drejtën e themelimit të një sindikate dhe lirinë e anëtarësimit në një të tillë.



### Neni 12

#### E drejta për t'u martuar

Çdokush ka të drejtë të martohet dhe të krijojë një familje.



### Neni 13

#### E drejta për zgjidhje efektive

Të gjithë personat duhet të kenë mjetet ligjore për ankim në gjykata, nëse të drejtat e tyre janë shkelur.



### Neni 14

#### Ndalimi i diskriminimit

Të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Konventë zbatohen për të gjithë personat, paravarsisht nga faktorët si, gjinia, ngjyra e lëkurës, feja, mendimet politike apo origjina.



### Neni 34

#### Kërkesat individuale

E drejta për të parashtruar kërkesë në GJEDNJ është absolute. Shtetet nuk mund të pengojnë ushtrimin e kësaj të drejte në asnjë rrethanë.



### Neni 1 i Protokollit Nr. 1

#### Mbrojtja e pronës

Të gjithë personat kanë të drejtën e zotërimit të pronës dhe të shfrytëzojnë pasurinë e tyre.



### Neni 2 i Protokollit Nr. 1

#### E drejta për arsim

Çdokush ka të drejtë për arsimim dhe edukim.



### Neni 3 i Protokollit Nr. 1

#### E drejta për zgjedhje të lira

Çdokush ka të drejtë të merr pjesë me votim të fshehtë në zgjedhjen e organit ligjvënës (pra, parlamentin shtetëror) dhe në zgjedhjen e Parlamentit Evropian.



### Neni 2 i Protokollit Nr. 4

#### Liria e lëvizjes

Të gjithë personat që ndodhen ligjërisht brenda një shteti mund të lëvizin lirshëm brenda tij dhe të zgjedhin vendin ku dëshirojnë të jetojnë.



### Neni 1 i Protokollit Nr. 6

#### Heqja e dënimit me vdekje

Askush nuk mund të dënohet me vdekje apo të ekzekutohet nga shteti.



### Neni 2 i Protokollit Nr. 7

#### E drejta e apelit në çështjet penale

Çdo person i shpallur fajtor për një veprë penale ka të drejtë për të apeluar çështjen e tij pranë një organi më të lartë gjyqësor.





### Neni 3 i Protokollit Nr. 7

#### Kompensimi për dënimin e padrejtë

*Të gjithë personat kanë të drejtë për kompensim nëse gjykatat i dënojnë pa të drejtë.*



### Neni 4 i Protokollit Nr. 7

#### E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë

*Askush nuk mund të gjykohet për të njëjtën veprimtari penale përveç nëse dëshmojnë fakte të reja.*



### Neni 5 i Protokollit Nr. 7

#### Barazia ndërmjet bashkëshortëve

*Bashkëshortët kanë të njëjtat të drejta dhe përgjegjësi, si ndaj njëri-tjetrit e po ashtu edhe ndaj fëmijëve të tyre.*



### Neni 1 i Protokollit Nr. 12

#### Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit

*Të gjithë personat duhet të jenë në gjendje të ushtrojnë të drejtat e tyre pa qenë të diskriminuar për arsye si, gjinia, ngjyra e lëkurës, besimi fetar, bindja politike apo origjina.*



### Neni 1 i Protokollit Nr. 13

#### Heqja e dënimit me vdekje

*Dënimi me vdekje ndalohet edhe në kohë lufte.*




## Shtojca 2: Shtetet nënshkruese të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore

e njohur më mirë si Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Romë, më 4 nëntor 1950)




-  Për Qeverinë e Mbretërisë së Belgjikës: **Paul VAN ZEELAND**
-  Për Qeverinë e Mbretërisë së Danimarkës: **Otto Carl MOHR**
-  Për Qeverinë e Republikës së Francës: **Robert SCHUMAN**
-  Për Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë: **Walter HALLSTEIN**
-  Për Qeverinë e Republikës së Islandës: **Petur BENEDIKTSSON**
-  Për Qeverinë e Republikës së Irlandës: **Seán MAC BRIDE**
-  Për Qeverinë e Republikës së Italisë: **Carlo SFORZA**
-  Për Qeverinë e Dukatit të Madh të Luksemburgut: **Joseph BECH**
-  Për Qeverinë e Mbretërisë së Vendeve të Ulta: **Dirk STIKKER**
-  Për Qeverinë e Mbretërisë së Norvegjisë: **Halvard Manthey LANGE**
-  Për Qeverinë e Zarës: **Edgar HECTOR**
-  Për Qeverinë e Republikës së Turqisë: **Mehmet Fuat KÖPRÜLÜ**
-  Për Qeverinë e Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut: **Ernest DAVIES**


### Shtojca 3: Data kyçe




For the Government of the Irish Republic: Pour le Gouvernement de la République irlandaise:



For the Government of the Italian Republic: Pour le Gouvernement de la République italienne:



For the Government of the Grand Duchy of Luxembourg: Pour le Gouvernement du Grand Duché de Luxembourg:



For the Government of the Kingdom of the Netherlands: Pour le Gouvernement du Royaume des Pays-Bas:



For the Government of the Kingdom of Norway: Pour le Gouvernement du Royaume de Norvège:

## Shtojca 4: Protokollet e Konventës

### Protokolli shtesë

Hyrja në fuqi: 18 maj 1954

*I njohur ndryshe si Protokolli Nr. 1; parashikon të drejta të reja, dhe në veçanti të drejtën për gëzimin paqësor të pasurisë, të drejtën për arsim dhe të drejtën për zgjedhje të lira me votim të fshehtë.*

### Protokolli Nr. 2

Hyrja në fuqi: 21 shtator 1970

*i jep kompetencë Gjykatës për të dhënë mendime këshillimore me kërkesë të Komitetit të Ministrave.*

### Protokolli Nr. 3

Hyrja në fuqi: 21 shtator 1970

*Ndryshon Nenet 29, 30 dhe 34 të Konventës.*

### Protokolli Nr. 4

Hyrja në fuqi: 2 Maj 1968

*Parashikon, në veçanti, për ndalimin e burgimit për mospërbushje të detyrimeve kontraktuale, të drejtën për lirinë e lëvizjes dhe lirinë e individit për të zgjedhur vendbanimin e tij, si dhe ndalimin e dëbimit të shtetasve dhe dëbimin kolektiv të të huajve.*

### Protokolli Nr. 5

Hyrja në fuqi: 20 dhjetor 1971

*Ndryshon nenet 22 dhe 40 të Konventës.*

### Protokolli Nr. 6

Hyrja në fuqi: 1 mars 1985

*Lidhur me heqjen e dënimit me rdekje.*

### Protokolli Nr. 7

Hyrja në fuqi: 1 nëntor 1988

*Parashikon, në veçanti, për të drejtën e apelimit në çështjet penale, të drejtën e kompensimit për një dënim të padrejtë, të drejtën për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë, dhe barazinë midis bashkëshortëve.*

### Protokolli Nr. 8

Hyrja në fuqi: 1 janar 1990

*Ndryshon funksionimin e Komisionit Evropian të të Drejtave të Njeriut.*



**Protokoll Nr. 9**

• Hyrja në fuqi: 1 tetor 1994

*U jep aplikuesve, në rrethana të caktuara, të drejtën për të kërkuar Gjykatës që të merret me çështjen e tyre.*



**Protokoll Nr. 10**

• Nënshkruar: 25 mars 1992

*Përmirëson procedurën e mbikëqyrjes së Konventës brenda sistemit të mëparshëm të saj (ky instrument humbi qëllimin e tij me hyrjen në fuqi të Protokollit Nr. 11).*



**Protokoll Nr. 11**

• Hyrja në fuqi: 1 nëntor 1998

*Themelon "Gjykatën e re".*



**Protokoll Nr. 12**

• Hyrja në fuqi: 1 prill 2005

*Paraqet një ndalim të përgjithshëm mbi diskriminimin.*



**Protokoll Nr. 13**

• Hyrja në fuqi: 1 korrik 2003

*Lidhur me heqjen e dënimit me rdekje në të gjitha rrethanat.*



**Protokoll Nr. 14**

• Hyrja në fuqi: 1 qershor 2010

*Parashikon, në rrethana të krijuara, krijimin e formacioneve të reja gjyqësore për çështjet më të drejtpërdrejta dhe një kriter të ri të pranueshmërisë. Ky Protokoll zgjati gjithashtu kohëzgjatjen e mandatit të gjyqtarëve nga gjashtë në nëntë vjet, të pa rinovueshëm.*



**Protokoll Nr. 15**

• Nënshkruar: 24 qershor 2013 - ende nuk ka hyrë në fuqi

*Paraqet një referencë në lidhje me parimin e subsidiaritetit dhe doktrinën e marzhit të vlerësimit. Ky propokoll ul afatin kohor për aplikimin në Gjykatë nga gjashtë muaj në katër.*



**Protokoll Nr. 16**

• Hyrja në fuqi: 1 gusht 2018

*U mundëson gjykatave të rangut më të lartë të Shteteve Palë t'i kërkojnë Gjykatës mendim këshillimor.*

## Shtojca 5: Grafiku i nënshkrimeve dhe ratifikimeve të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Traktati Nr. 005)

	Nënshkrimi	Ratifikimi	Hyrja në fuqi
Shqipëria	13/07/1995	02/10/1996	02/10/1996
Andorra	10/11/1994	22/01/1996	22/01/1996
Armenia	25/01/2001	26/04/2002	26/04/2002
Austria	13/12/1957	03/09/1958	03/09/1958
Azerbajxhani	25/01/2001	15/04/2002	15/04/2002
Belgjika	04/11/1950	14/06/1955	14/06/1955
Bosnja dhe Hercegovina	24/04/2002	12/07/2002	12/07/2002
Bullgaria	07/05/1992	07/09/1992	07/09/1992
Kroacia	06/11/1996	05/11/1997	05/11/1997
Qipro	16/12/1961	06/10/1962	06/10/1962
Republika Çeke	21/02/1991	18/03/1992	01/01/1993
Danimarka	04/11/1950	13/04/1953	03/09/1953
Estonia	14/05/1993	16/04/1996	16/04/1996
Finlanda	05/05/1989	10/05/1990	10/05/1990
Franca	04/11/1950	03/05/1974	03/05/1974
Gjeorgjia	27/04/1999	20/05/1999	20/05/1999
Gjermania	04/11/1950	05/12/1952	03/09/1953
Greqia	28/11/1950	28/11/1974	28/11/1974
Hungaria	06/11/1990	05/11/1992	05/11/1992
Islanda	04/11/1950	29/06/1953	03/09/1953
Irlanda	04/11/1950	25/02/1953	03/09/1953
Italia	04/11/1950	26/10/1955	26/10/1955
Letonia	10/02/1995	27/06/1997	27/06/1997
Lihtenshtajni	23/11/1978	08/09/1982	08/09/1982
Lituania	14/05/1993	20/06/1995	20/06/1995

	Nënshkrimi	Ratifikimi	Hyrja në fuqi
Luksemburg	04/11/1950	03/09/1953	03/09/1953
Malta	12/12/1966	23/01/1967	23/01/1967
Republika e Moldavisë	13/07/1995	12/09/1997	12/09/1997
Monaco	05/10/2004	30/11/2005	30/11/2005
Mali i Zi	03/04/2003	03/03/2004	06/06/2006
Vendet e Ulëta	04/11/1950	31/08/1954	31/08/1954
Maqedonia e Veriut	09/11/1995	10/04/1997	10/04/1997
Norvegjia	04/11/1950	15/01/1952	03/09/1953
Polonia	26/11/1991	19/01/1993	19/01/1993
Portugalia	22/09/1976	09/11/1978	09/11/1978
Rumania	07/10/1993	20/06/1994	20/06/1994
Federata Ruse	28/02/1996	05/05/1998	05/05/1998
San Marino	16/11/1988	22/03/1989	22/03/1989
Serbia	03/04/2003	03/03/2004	03/03/2004
Republika Sllovake	21/02/1991	18/03/1992	01/01/1993
Sllovenia	14/05/1993	28/06/1994	28/06/1994
Spanja	24/11/1977	04/10/1979	04/10/1979
Suedia	28/11/1950	04/02/1952	03/09/1953
Zvicra	21/12/1972	28/11/1974	28/11/1974
Turqia	04/11/1950	18/05/1954	18/05/1954
Ukraina	09/11/1995	11/09/1997	11/09/1997
Mbretëria e Bashkuar	04/11/1950	08/03/1951	03/09/1953

Grafiku i nënshkrimeve dhe ratifikimeve të Protokolleve të Konventës gjendet në faqen e internetit të zyrës së Traktatit: [www.coe.int/en/web/conventions](http://www.coe.int/en/web/conventions).

# Konventa origjinale






ENG

[www.echr.coe.int](http://www.echr.coe.int)

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Në të bëjnë pjesë 47 shtete anëtare, duke përfshirë të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokumenti i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane mbikëqyr zbatimin e Konventës nga shtetet anëtare.



EUROPEAN COURT OF HUMAN RIGHTS  
COUR EUROPÉENNE DES DROITS DE L'HOMME

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE